

VENDIM
Nr. 141, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023 me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me seli në adresën: Lagja “Hajro Çakërr”, Rruga “Sulejman Delvina”, Vlorë.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami